

20130250766

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PËR SIGURI DHE
SHENDET GJATE PUNES

Neni 1

Në Ligjin për siguri dhe shendet gjate punes ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 92/2007 dhe 136/11), në nenin 22 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Llojin, menyren, vellimin dhe listen e cmimeve të kontrolleve mjekesore me propozim të ministrit kompetent për punet nga sfera e punes, pas mendimit paraprak të ministrit kompetent për punet nga sfera e shendetesise, i rregullon Qeveria e Republikës së Maqedonisë."

Pas paragrafit (3) shtohen tre paragrafe të rinj (4), (5) dhe (6), si vijojne:

"(4) Institucioni i autorizuar shendetesor detyrohet që t'i kryeje kontrollet shendetesore, në pajtim me llojin, menyren, vellimin dhe listen e cmimeve nga rregulla nga paragrafi (2) i ketij neni.

(5) Institucioni i autorizuar shendetesor detyrohet që t'i kryeje kontrollet shendetesore në pajtim me minimumin standard që eshte i detyrueshem për të gjitha kontrollet sistematike, paraprake, të orientuara dhe periodike, që perbehet prej:

- të dhenave të anamnezës (anamneza e punes, veshtiresite kryesore, semundja e tashme, anamneza familjare, anamneza personale, të dhena sociale-epidemiologjike).

- statusit sipas sistemeve dhe antropometrise (masa trupore, lartesia trupore dhe indeksi i mases trupore),

- analizave themelore laboratorike si vijon, sedimentacioni, pasqyra e gjakut (eritrocitet, hemoglobina, hematokriti, leukocitet, glikemia, kolesterioli, trigliceridet, urina, sheqeri, proteina, bilirubina, urobilinogeni, sedimenti),

- analizes së funksionit të të parit (mprehtesia e të parit për afersi dhe largesi),

- audiometrise,

- spirometrise,

- EKG (12) kanaleve dhe

- radiografise së kraharorit - me vendim të mjekut.

(6) Varesisht nga vleresimi i rrezikut në vendin e punes dhe karakteristikat e demeve të definuara profesionale dhe rreziqeve krahas minimumit standard behen edhe kontrolle plotesuese nga rregulla nga paragrafi (2) i ketij neni."

Neni 2

Pas nenit 51 shtohet nen i ri 51-a, si vijon:

"Neni 51-a

Për mbrojtje të shendetit të të punesuarve dhe kontrollet të cilat duhet të kryhen mbi të punesuarit, Inspektorati Shteteror Shendetesor dhe Sanitar dhe Inspektorati Shteteror i Punes kryejne njekohesisht mbikeqyrje mbi zbatimin e rregulles nga neni 22 paragrafi (2) i ketij ligji."

Neni 3

Në nenin 58 paragrafi (1) pas alineze 6 shtohet alineja e re 7, si vijon:

"- nuk kryen kontrolle shendetesore për të punesuarit sipas llojit, menyres, vellimit dhe listes së cmimeve në pajtim me nenin 22 paragrafi (2) i ketij ligji".

Neni 4

Rregulla nenligjore e parapare me kete ligj do të miratohet në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Neni 5

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvenes i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për siguri dhe shëndet gjatë punës.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".